



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

Nr. /
Datë: 22.11.2024

Ministria e Ministrisë së Ekonomisë, në mbështetje të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 paragrafi 5, nenit 16 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 18 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08-L 258 për Promovimin e Përdormit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, merrë këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet fillimi i Procesit të Ofertimit Konkurrues, bazuar në teknologji të energjisë së ripërtërishme nga era, i cili do të zhvillohet në dy faza.
2. Procesi i Ofertimit Konkurrues dhe dokumentacioni përkatës do të bazohet në parimet e transparencës dhe konkurrencës, duke u siguruar që dhënia e kontratës për mbështetje të bëhet në bazë të kriterëve objektive, jodiskriminuese që sigurojnë pjesëmarrjen e ofertuesve me përvojën e nevojshme për realizimin e projektit.
3. Procesi i ofertimit konkurrues për ndërtimin e kapaciteteve do të zhvillohet marrë parasysh të dhënat si në vijim:
 - 3.1. Teknologjia e energjisë së ripërtërishme do të jetë nga era;
 - 3.2. Kapaciteti total i instaluar për të cilin parashihet të jepet mbështetja do të jetë deri në 100 MW;
 - 3.3. Rregullat e arritjes së kapacitetit të instaluar për ofertën fituese të shpallur në Procesin e Ofertimit Konkurrues do të përcaktohen sipas akteve nënligjore dhe në dokumentacionin e ofertimit;
 - 3.4. Ndërtimi i impiantit të erës do të zhvillohet në vendndodhje të pacaktuar;
 - 3.5. Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë një Marrëveshje për Blerje të Energjisë Elektrike (MBE), e konvertueshme në Kontratë për Diferencë sipas Ligjit Nr.08-L 258 për Promovimin e Përdormit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, me entitetin që ushtron kompetencat e Operatorit të Burimeve të Ripërtërishme dhe do të përfitojë nga një çmim i garantuar për çdo megavat-orë (MWh) të energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i tyre i erës. Çmimi i garantuar do të jetë çmimi më i ulët i pranuar nga ofertuesi i përgjegjshëm gjatë procesit të ofertimit konkurrues. Kohëzgjatja e MBE do të përcaktohet në dokumentacion të ofertimit për një periudhë prej së paku 15 vitesh;
 - 3.6. Faza e Kërkesës për Kualifikim (KPK) do të shpallet më së voni në dhjetor 2024 dhe do të jetë e hapur për së paku gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike, ndërsa Faza e Kërkesës për Propozime (KPP) do të jetë gjithashtu e hapur për së paku gjashtëdhjetë (60) ditë

kalendarike. Realizimi i projektit do të përcaktohet në Marrëveshjen për Zhvillim e Projektit;

- 3.7. Dokumentacioni i ofertimit do të parasheh kërkesa specifike rreth dëshmisë për pronarët përfundimtar fitues;
 - 3.8. Dokumentacioni i ofertimit do të përfshijë kërkesat e Ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
 - 3.9. Dokumentacioni i ofertimit do të përfshijë dëshmi mbi përmbushjen e kërkesave të përcaktuara, duke përfshirë përvojën përkatëse në ndërtimin e impianteve të energjisë me teknologji të erës dhe kapacitet të ngjashëm, si dhe aftësisë për realizimin e investimit brenda afatit të paraparë, të mbështetur nga dëshmi për zhvillimin e projekteve, ndërtimin e impianteve të ngjashme, dhe operimin e tyre;
4. Afatet dhe kushtet e tjera të zbatueshme do të përcaktohen në dokumentacionin e ofertimit.
 5. Kapaciteiti i erës nga pika 3 e këtij vendimi do të jetë pjesë e caktuar afatgjatë dhe vjetor të kapacitetit të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë deri në vitin 2030 në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2022-2031 dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 për Cakun e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
 6. Ofertuesi i suksesshëm për ndërtimin e impiantit të erës, do të përzgjidhet ofertuesi që ofron çmimin më të ulët të garantuar për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar sipas akteve përkatëse nënligjore dhe dokumentacionit të ofertimit.
 7. Obligohet Njësia për zbatim të projekteve nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të shpallur Procesin e Ofertimit Konkurrues, përfshirë dokumentacionin e ofertimit dhe marrëveshjet përkatëse për mbështetje dhe zhvillim të projektit, dhe siguruar përmbyllje të suksesshme të tij, sipas këtij Vendimi.
 8. Obligohen njësitë tjera të Ministrisë së Ekonomisë që përgjatë gjithë procesit të oftojnë mbështetje dhe këshilla për Njësinë për implementim të projekteve nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
 9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Artane Ryzvanolli

Ministër e Ekonomisë



Iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- Njësia për Implementim të Projekteve nga BRE;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit.